

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE

“XORO BETON “ Shpk

Sot me date 18.12.2024 ne baze te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare » i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit, ne dispozitat e Kodit Civil si mblidhen me vullnetin e tyre te lire individet si me poshte :

- Z.Alqi Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi : I10927145V, i datelindjes 27.09.1981, me vendlindje Cerkovice, me zotesi te plote per te vepruar
- Z.Lefter Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi : I60303112V, i datelindjes 03.03.1986 , me vendlindje Cerkovice, me zotesi te plote per te vepruar
- Z.Nasho Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi : H60925085I, i datelindjes 25.09.1976, me vendlindje Cerkovice, me zotesi te plote per te vepruar

KREU 1

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot ne date 18.12.2024, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin “ XORO BETON “ Shpk

Themelueset e shoqerise jane :

- Z.Alqi Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi : I10927145V, i datelindjes 27.09.1981, me vendlindje Cerkovice
- Z.Lefter Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi : I60303112V, i datelindjes 03.03.1986 , me vendlindje Cerkovice
- Z.Nasho Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi : H60925085I, i datelindjes 25.09.1976, me vendlindje Cerkovice

NENI. 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

Ndertime Civile e Industriale, Prodhime materiale betoni, Prodhime Inerte dhe nenprodukte te tyre, Hapje Linje Inerte dhe Linje betoni. Perdorim Lende plasese dinamike, kapsolla detopnatore, magazinimin e tyre, per punimet ne linjat inerte, prodhim i asfalto~betonit, betoneve, rikonstrukcion te objekteve, ndertim digash, perforcime themeli dhe izolime mbi dhe nentokesore, lysterje fasadash dhe lysterje te objekteve, hidroizolime, punime te mirembajtjes dhe sinjalistikes rrugore, ndertim mbishtresash rrugore, ndertim te urave, rruges, punime karpentjerie prej druri dhe konstruksione metalike, prodhim te tyre dhe ndertime objektesh me fasada xhami, importe, eksporte dhe tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem , inerte dhe nenprodukteve te tyre, te prodhimeve te betonit. Shitje te pasurive te paluajtshme, te realizuara gjate ndertimit, hyrja ne marredhenie bashkepunimi me persona te trete, fizik ose juridik, hapje te Agjensive Imobilare. Ndertime civile e industriale, punime te ndryshme dherash, betoni, beton arme, ndertime civile, vepra arti, kanalizime, rikonstrukcion godinash, veshje fasadash, prodhime druri , metalike, plastike per dyer dhe dritare. Te ofroj, kryej dhe drejtoj sherbime sipermarjeje, projekte dhe veprimtari te te gjitha llojeve. Te krijoj, bleje, financoje, investoje, te hyje ne mardhenie me te trete.

NENI. 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te aktivitetit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI. 4
SELIA E SHOQERISE

- Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Vlore Sarande Rruga "Telat Noga", njesia 13/58-N18,Zona kadastrale 8641,Lagja nr.1, Sarande. 9701
- Nr kontakti per shoqerine, tel: 067 40 23 193
- Adresa email e shoqerise: lefter.xoro@xorobeton.com

KREU II
KAPITALI
NENI. 5
KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 1.000.000 (nje milion) leke i perbere nga 3 kuota.

Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte :

- Z.Alqi Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi: I10927145V, i datelindjes 27.09.1981, me vendlindje Cerkovice, me zotesi te plote per te vepruar i cili zoteron 1 kuote, 40 % te shoqerise ne vleren perkatesisht 400.000 leke.
- Z.Lefter Xoro,shtetas shqiptar, me numer identifikimi: I60303112V, i datelindjes 03.03.1986 , me vendlindje Cerkovice, me zotesi te plote per te vepruar , i cili zoteron 1 kuote, 20 % te shoqerise ne vleren perkatesisht 200.000 leke.
- Z.Nasho Xoro,shtetas shqiptar, me numer identifikimi: H60925085I,i datelindjes 25.09.1976, me vendlindje Cerkovice, me zotesi te plote per te vepruar , i cili zoteron 1 kuote, 40 % te shoqerise ne vleren perkatesisht 400.000 leke.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin te regjistruar te shoqerise.


Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuatat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise



- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE NENI. 8 ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f) Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) Miratimi i bilanceve
- h) Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l) Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njehtin rend dite.

NENI 9 THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

NENI 10 KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi te permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mbledhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqsohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKB .

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te plota sic parashikohet ne ligjin nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare » i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligji nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit,

- Z.Lefter Xoro , shtetas shqiptar, me numer identifikimi : I60303112V, i datelindjes 03.03.1986 , me vendlindje Cerkovice, me zotesi te plote per te vepruar

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoreti kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregtare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit

- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.
- i) Te kryeje te gjitha pagesat nga llogara bankare e kompanise per instuticionet shteterore.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundershtrim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregetare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b) Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c) Me hapjen e procedurave te falimentit
- d) Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare et Regjistrimit,
- e) Me vendim gjykate.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

ART. 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jetë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën. Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në asamblenë e parë të përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave në sipas dispozitave të nenëve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregëtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".

NENI 22

MOSMARRVESHJET

Për mosmarrvëshjet midis ortakëve të shoqërisë, ose shoqërisë me të tretet, gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua në 2 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Alqi Xoro

Alqi Xoro


Lefter Xoro

Lefter Xoro


Nasho Xoro

Nasho Xoro
